

BASHKËPUNIMI SHQIPËRI-MAQEDONI E VERIUT



KËSHILLI I INTEGRIMIT EUROPIAN



PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT FISKAL ME BE



REFORMA E FISKALIZIMIT



RRITJA E SIGURISË NË PIKAT E KALIMIT KUFITAR



PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



Ministrja Anila Denaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut, ku u takua me Ministren e Financave dhe Ministrin e Ekonomisë, z. Kreshnik Bekteshi. Takimi me ministren e Financave konsistoi në shkëmbimin e eksperiencave në luftën ndaj evazionit fiskal dhe punës në të zehtë, e cila do të formalizohet në nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi mes administratave fiskale respektive brenda muajit shkurt. Në takimin me ministrin e Ekonomisë u diskutua mbi politikat zhvilluese ekonomike, mbi mundësinë e krijimit të lehtësive mes bizneseve të dy vendeve dhe mbi përfundimin e negociatave për pikën e përbashkët kufitare në Qafë Thanë, duke synuar krijimin e një "one stop shop" për të gjithë shërbimet. Shkëmbimi i eksperiencave në fushën e përafrimit të legjislacionit evropian ishte një tjetër pikë diskutimi gjatë takimeve të zhvilluar nga Ministrja Denaj me homologët e Maqedonisë së Veriut.

Ministrja Denaj mori pjesë në Këshillin e Integrimit Europian, ku tema kryesore e diskutimit ishte lufta ndaj korrupsionit. Ministrja informoi mbi zbatimin e reformave strukturore në sektorët kryesorë strategjikë që prekin ekonominë, të cilat në themel kanë përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit në vend, përfshirë edhe qasjen tonë ndaj korrupsionit në sektorin privat. MFE ka thjeshtuar punën e biznesit përmes procedurave dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës, duke ndikuar drejtpërdrejt në përpjekjet kundër evazionit fiskal dhe informalitetit; reduktimin e shërbimeve të marra në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sportelet; ndryshimet ligjore të nevojshme me fokus përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së raportimit financiar në vend, në kontekstin e aspiratave integruese dhe në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së.

Ministrja Denaj priti në takim një delegacion të OECD-së, të kryesuar nga zëvendëssekretari i përgjithshëm z.Ludger Schuknecht. Ministrja Denaj informoi mbi hapat që ka hedhur Shqipëria në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ratifikimi i marrëveshjes kuadër gjithëpërfshirës i projektit ndërkombëtar BEPS (erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimeve), angazhime të tjera nga Instrumentet Multi-Lateral dhe nga Shkëmbimi Automatik i Informacionit. Ministrja Denaj siguroi se i gjithë ky proces është një garanci drejt të gjithë rrugëtimit legjislativ drejt komunitetit evropian në aspektin e taksimit të drejtë, çka do të sjellë më shumë garanci për investitorët e huaj në aspektin e kuadrit ligjor që zbaton Shqipëria.

Në përfundim të procesit të konsultimit publik të akteve nënligjore për procesin e fiskalizimit, grupi i punës diskutoi në mbledhjen e radhës mbi përcaktimin e kriterëve për përdorimin e procedurës së thjeshtëzuar, kërkesave teknike dhe funksionale të programit të fiskalizimit dhe pajisjeve ekzistuese fiskale. Angazhimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të jetë me të njëjtin ritëm të vitit të shkuar. Përmirësimi i administrimit fiskal dhe përpjekjet e vazhdueshme për reduktimin sistematik të informalitetit në ekonomi vazhdojnë të mbeten prioritet. Fiskalizimi do të sigurojë transparencë dhe kontroll në transaksionet tregtare dhe, në periudhën afatmesme, do të rrisë parametrat e TVSH-së dhe saktësinë e të dhënave në administratën tatimore.

Përurohet zyra e Njësisë për Kontrollin e Kargove Ajrore në Aeroportin e Rinasit. Në ceremoninë e rastit mori pjesë Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Gjon Bardhi, së bashku me Zv.Ministrën e Brendshme, Rovena Voda dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ardi Veliu. Kreu i Doganave vlerësoi projektin për Kontrollin e Kargos në Aeroportin e Rinasit, i ofruar nga ana e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet, si një nevojë për t'ju përgjigjur në mënyrë sa më eficiente rreziqeve të ndryshme me të cilat përballat siguria e aeroportit në ditët e sotme, por edhe si një parapërgatitje për rriset që mund të vijnë duke u shtuar, diversifikuar dhe sofistikuar në të ardhmen. Kontributi i Administratës Doganore, theksoi Bardhi, do të jetë kyç dhe i një roli vendimtar në implementimin sa më korrekt të një Projekti të tillë.

320 persona janë punësuar në gjithë vendin nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të Punës gjatë periudhës 30 janar - 6 shkurt 2020.